



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1539/1 prot.

Tiranë, më 28/03/2020

URDHËR

Nr. 193/1, datë 28.03.2020

**PËR DISA NRYSHIME NË URDHËRIN NR 193 DATË 20.03.2020 “PËR  
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**U R D H Ë R O J:**

Në urdhërin nr.193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Kufizimin e lëvizjes, në gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, ciklomotor, motomjete dhe mjete) duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 28.3.2020 deri në orën 05:00, të datës 30.3.2020. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si dhe shërbimet në banesë (delivery).”

2. Fjalja e parë e pikës 3 riformulohet si vijon:

“Ndalohej ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1 dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 28.3.2020, deri në orën 05:00, datë 30.3.2020.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1.Duke filluar nga ora 05:00 e datës 30.3.2020 lejohet për të dalë nga banesa për të bërë blerje për furnizime familjare vetëm një person nga familja, pasi të ketë marrë lejën digjitale me e-mail ose telefon në emër të familjes ne faqet e internetit të autoritetit përgjegjës”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**

